



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN

# PROGRAMI I PUNËS

## QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN

*Periudha qershor-dhjetor 2023*

Miratoi

DREJTORI  
Mimoza ÇULIQI



## PËRMBAJTJA

<b>1. QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN</b>	<b>3</b>
1.1 Misioni	3
1.2 Vizioni	3
1.3 Objektivat e përgjithshëm të QBD-së, për periudhën qershor-dhjetor 2023	4
<b>2. SEKTORI I BOTIMIT, KOORDINIMIT DHE SHPËRNDARJES</b>	<b>5</b>
2.1 Detyrat kryesore	5
2.2 Objektivat e përgjithshëm të Sektorit të Botimit, Koordinimit dhe Shpërndarjes	5
2.3 Objektivat e detajuar të Sektorit të Botimit, Koordinimit dhe Shpërndarjes	6
2.4 Plani i veprimtarive të Sektorit të Botimit, Koordinimit dhe Shpërndarjes	7
<b>3. SEKTORI I KOMUNIKIMIT, DIGJITIMIT DHE PROJEKTEVE</b>	<b>10</b>
3.1 Detyrat kryesore	10
3.2 Objektivat e përgjithshëm të Sektorit të Komunikimit, Digjitimit dhe Projekteve	10
3.3 Objektivat e detajuar të Sektorit të Komunikimit, Digjitimit dhe Projekteve	11
3.4 Plani i veprimtarive të Sektorit të Komunikimit, Digjitimit dhe Projekteve	12
<b>4. SEKTORI I FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE</b>	<b>14</b>
4.1 Detyrat kryesore	14
4.2 Objektivat e përgjithshëm të Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse	14
4.3 Objektivat e detajuar të Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse	14
4.4 Plani i veprimtarive të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse	15



## 1. QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN

Qendra e Botimeve për Diasporën është institucion i krijuar me VKM-në nr. 469, datë 26.07.2018, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën”, të ndryshuar, që financohet nga buxheti i shtetit. Ajo ka qenë në varësi të Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe prej vitit 2022 organizohet e funksionon në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

### 1.1 MISIONI

Qendra e Botimeve për Diasporën ka për mision:

- Mbështetjen e mësimit të gjuhës shqipe;
- Njohjen dhe përhapjen e kulturës kombëtare në diasporë përmes botimit të teksteve shkollore, botimit të librave me përmbajtje letrare, historike dhe sociale;
- Organizimin dhe mbështetjen e veprimtarive edukative, kulturore dhe sociale, që kanë për qëllim ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës shqipe dhe kulturës amtare në diasporë.

### 1.2 VIZIONI

Qendra është në shërbim të misionit të ministrit përgjegjës për arsimin në përfaqësimin dhe nxitjen e politikave të bashkëpunimit dhe të ndërveprimit me të gjithë shqiptarët, me qëllim fuqizimin dhe bashkëpunimin në të gjitha fushat me shqiptarët jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe shtetet ku ata banojnë.



#### 1.4 OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM TË QBD-SË, PËR PERIUDHËN QERSHOR-DHJETOR 2023

Qendra e Botimeve për Diasporën synon të arrijë këto objektiva për periudhën qershor-janar 2023:

1. Sigurimin e teksteve mësimore për zhvillimin e mësimit të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë;
2. Sigurimin e teksteve dhe materialeve plotësuese për zhvillimin e mësimit të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë;
3. Koordinimin e punës së Komisionit e Përbashkët të Shqipëri-Kosovë për miratimin e teksteve mësimore për diasporën, niveli II dhe niveli III;
4. Sigurimin e një komunikimi dhe lidhje të vazhdueshme me anëtarët e diasporës;
5. Organizimin e aktiviteteve dhe veprimtarive në ndihmë të përhapjes së gjuhës dhe kulturës amtare në diasporë.

## 2. SEKTORI I BOTIMIT, KOORDINIMIT DHE SHPËRNDARJES

### 2.1 DETYRAT KRYESORE

Detyrat kryesore të Sektorit të Botimit, Koordinimit dhe Shpërndarjes, në QBD janë:

- Sigurimi i teksteve mësimore, literaturës plotësuese dhe botimeve të QBD-së për vitin shkollor 2023–2024, referuar kërkesave që do të vijnë nga MEPJ-ja;
- Ndjekja e procesit të përgatitjes për botim të literaturës plotësuese dhe botimeve të QBD-së për diasporën;
- Ndjekja dhe koordinimi i punës së Komisionit të Përbashkët Shqipëri-Kosovë për miratimin e teksteve mësimore për diasporën, në funksionin e sekretarisë teknike të këtij komisioni;
- Ndjekja dhe koordinimi i punës së Grupit të Përbashkët të punës Shqipëri-Kosovë për organizimin e Seminarit XVI të mësimit plotësues në diasporë;
- Mbajtja e lidhjeve të vazhdueshme me mësuesit e gjuhës shqipe në diasporë, Lidhjet e Mësuesve të Gjuhës Shqipe në Diasporë dhe personat e interesuar për ruajtjen e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare;
- Përditësimi i bazës së të dhënave të shkollave / kurseve dhe mësuesve të gjuhës shqipe në diasporë;
- Bashkërendimi i punës për shpërndarjen e botimeve të QBD-së për diasporën.

### 2.2 OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM TË SEKTORIT TË BOTIMIT, KOORDINIMIT DHE SHPËRNDARJES

Spektori i Botimit, Koordinimit dhe Shpërndarjes ka këta objektiva të përgjithshëm për periudhën qershor-dhjetor 2023:

- Organizimi i procesit të sigurimit të tekstit mësimor të përbashkët “Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare”, Niveli I;
- Përgatitja e literaturës plotësuese në ndihmesë të mësimdhënies në diasporë;
- Përditësimi i bazës së të dhënave të mësuesve, shkollave/kurseve të mësimit të gjuhës shqipe në diasporë.

## 2.3 OBJEKTIVAT E DETAJUAR TË SEKTORIT TË BOTIMIT, KOORDINIMIT DHE SHPËRNDARJES

Sektori i Botimit, Koordinimit dhe Shpërndarjes ka këta objektiva të detajuar për periudhën qershor-dhjetor 2023:

- Sigurimi i teksteve mësimore për diasporën;
- Ndjekja dhe koordinimi i punës së Komisionit të Përbashkët Shqipëri-Kosovë për miratimin e tekstit mësimor të përbashkët “Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare”, Niveli II dhe “Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare”, Niveli III;
- Ndjekja dhe koordinimi i punës së Grupit të Përbashkët të punës Shqipëri-Kosovë për organizimin e Seminarit XVI të mësimin plotësues në diasporë;
- Përditësimi i bazës së të dhënave të mësuesve, shkollave/kurseve të mësimin të gjuhës shqipe në diasporë.

### PROGRAMI I BOTIMEVE DYGJUHËSHE, PROJEKTE 2-VJEÇARE DHE TË TJERA

- Realizimi i botimit dygjuhësh i projektit “*Jam shqiptar*”, një cikël me materiale didaktike për mësimdhënien në diasporë, me udhërrëfyes të trashëgimisë kulturore për 10 qytete të Shqipërisë dhe Kosovës, në pesë gjuhë: shqip-anglisht, shqip-italisht, shqip-frëngjisht, shqip-greqisht dhe shqip-gjermanisht.
  - Koordinimi dhe ndjekja e punës së grupit të krijuar (autor – ilustrator) për përgatitjen e materialeve. Deri në fund të këtij viti do të përgatiten materialet **për 5 qytete**: Gjirokastra, Shkodra, Berati, Prizreni dhe Gjakova.
  - Redaktimi i materialeve të përgatitura në bashkërendim me grupin e punës.
- Realizimi i botimit dygjuhësh të vëllimit me poezi të përzgjedhura nga krijimtaria e shkrimtarit Dritëro Agolli në pesë gjuhë: shqip-anglisht, shqip-italisht, shqip-greqisht, shqip-gjermanisht dhe shqip-frëngjisht.
  - Përzgjedhja e përkthyesve për realizimin e përkthimit në 5 gjuhë **të 50 poezive të përzgjedhura**;
- Koordinimi i punës me Sektorin e Komunikimit, Digjimit dhe Projekteve për realizimin e botimit dygjuhësh (shqip-anglisht) të numrit të tretë të Revistës Letrare;
- Fillimi i punës për botimin e teksteve plotësuese për mësimdhënien në diasporë të përshtatura me planprogramet pedagogjike për gjuhën amtare në Suedi;
- Vlerësimi i punonjësve për 6-mujorin;
- Përgatitja e raportimit vjetor për Sektorin e Botimit, Koordinimit dhe Shpërndarjes.

## 2.4 PLANI I VEPRIMTARIVE TË SEKTORIT TË BOTIMIT, KOORDINIMIT DHE SHPËRNDARJES

OBJEKTIVI	MASAT E PËRGJITHSHME	PERIUDHA	REZULTATI
Sigurimi i teksteve mësimore për diasporën.	Bashkërendimi ndërinstytucional me MEPJ-në me qëllim mbledhjen e kërkesave përfundimtare për tekste mësimore të dërguara nga Ambasadat Shqiptare dhe përfaqësitë tona diplomatike në diasporë.	Qershor 2023	Mbledhja e kërkesave për tekste mësimore.
	Ndjekja e mbledhjes së Këshillit Koordinues për miratimin e listës përfundimtare të teksteve që do të dërgohen për zhvillimin e mësimin të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare, për vitin mësimor 2023-2024.	Qershor 2023	Lista e miratuar e teksteve mësimore.
Koordinimi i punës për shpërndarjen e teksteve mësimore për vitin shkollor 2023-2024.	Ndërveprimi i QBD-së me MEPJ-në për përgatitjen e dërgesave të librave sipas shteteve.	Gusht-shtator 2023	Vendosja e kontakteve me shkollat shqipe, shoqatat kulturore dhe mësuesit në diasporë për sigurimin e kërkesave për tekstet mësimore.
	Analizë për dërgesën e teksteve mësimore dhe përgatitja e raportit përfundimtar.	Tetor 2023	Përgatitja e raportit përfundimtar.
Koordinimi dhe ndjekja e punës së grupit ndërinstytucional Shqipëri-Kosovë për miratimin e teksteve mësimore për diasporën, Niveli II dhe Niveli III.	Realizimi i koordinimit me strukturat e përbërëse të MAS-it dhe MASHT-it Kosovë.	Gjatë 6-mujorit	Koordinimi i veprimtarisë së Komisionit.
	Pjesëmarrja e QBD-së në takimet e Komisionit të Përbashkët Shqipëri-Kosovë.	Gjatë 6-mujorit	Mbajtja e procesverbaleve dhe dokumentacionit të nevojshëm gjatë mbledhjeve të Komisionit, në cilësinë e sekretariatit teknik.

Ndjekja dhe koordinimi i punës së Grupit të Përbashkët të punës Shqipëri-Kosovë për organizimin e Seminarit XVI të mësimin plotësues në diasporë	Realizimi i koordinimit me strukturat e përbërëse të MAS-it dhe MASHT-it Kosovë.	Deri në gusht 2023	Koordinimi i veprimtarisë së Grupit të Përbashkët të punës.
	Pjesëmarrja e QBD-së në takimet e Grupit të Përbashkët të punës Shqipëri-Kosovë.	Deri në gusht 2023	Mbajtja e procesverbaleve dhe dokumentacionit të nevojshëm gjatë mbledhjeve të Grupit të përbashkët të punës, në cilësinë e sekretariatit teknik.
Përditësimi i bazës së të dhënave të mësuesve, shkollave dhe kurseve të mësimin të gjuhës shqipe në diasporë.	Mbajtja e kontaktit të vazhdueshëm me shkollat/kurset e mësimin të gjuhës shqipe dhe mësues të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë.	Gjatë 6-mujorit	Ruajtja e lidhjeve të QBD-së me shkollat dhe mësuesit në diasporë. Krijimi i mundësive të bashkëpunimit dhe partneriteteve të reja.
	Përditësimi i bazës së të dhënave të shkollave/kurseve dhe mësuesve të gjuhës shqipe në diasporë të krijuar nga QBD-ja prej 4 vitesh.	Gjatë 6-mujorit	Krijimi i një baze të dhënash të plotë që nevojitet për të ruajtur dhe për të menaxhuar të dhënat në mënyrë sa më të vlefshme.
<b>PROGRAMI I BOTIMEVE DYGJUHËSHE, PROJEKTE 2-VJEÇARE</b>			
Realizimi i botimit dygjuhësh i projektit “Jam shqiptar” në pesë gjuhë: shqip-anglisht, shqip-italisht, shqip-frëngjisht, shqip-greqisht dhe shqip-gjermanisht.	Koordinimi dhe ndjekja e punës së grupit të krijuar (autor-ilustrator) për përgatitjen e materialeve. Deri në fund të këtij viti do të përgatiten materialet për 5 qytete (nga 10 qytete të Shqipërisë dhe të Kosovës që janë gjithsej): Gjirokastra, Shkodra, Berati, Prizreni dhe Gjakova.	Qershor-shtator 2023	Përfundimi i materialeve për tre qytete: Gjirokastrë, Shkodër dhe Berat.
		Tetor-dhjetor	Përfundimi i materialeve për dy qytete: Prizren dhe Gjakovë.
	Redaktimi i materialeve të përgatitura në bashkërendim me grupin e punës	Gjatë 6-mujorit	Në komunikim të vazhdueshëm me autorin e materialeve do të realizohet dhe përgatitja përfundimtare e tyre për faqosje.



Realizimi i botimit dygjuhësh të vëllimit me poezi të përzgjedhura nga krijimtaria e shkrimtarit Dritëro Agolli në pesë gjuhë: shqip-anglisht, shqip-italisht, shqip-greqisht, shqip-gjermanisht dhe shqip-frëngjisht.	Përzgjedhja e përkthyesve për realizimin e përkthimit në 5 gjuhë.	Qershor 2023	Përfundimi i procesit të përzgjedhjes së përkthyesve që do të merren me përkthimin e poezive që përzgjedhura nga vëllimi i D. Agollit.
	Përcaktimi i redaktorëve shkencorë përmes bashkëpunimit me Fakultetin e Gjuhëve të Huaja dhe realizimi i redaktimit dhe korrektimit	Nëntor 2023	Përfundimi i redaktimit të përkthimit.
	Faqosja e botimit dygjuhësh	Dhjetor 2023	Përfundimi i faqosjes së botimit dygjuhësh.
Përshtatja e teksteve plotësuese për mësimdhënien në diasporë, të publikuara online nga QBD-ja, me planprogramet pedagogjike për gjuhën amtare në Suedi	Fillimi dhe organizimi i punës për zbatimin e projektit	Gjatë 6-mujorit	
Realizimi i botimit dygjuhësh, shqip-anglisht, të numrit të tretë të Revistës Letrare.	Ngritja e redaksisë së revistës letrare që do të merret me përgatitjen e numrit të tretë të revistës.	Qershor-dhjetor 2023	Botimi në format digjital dhe fizik i numrit të tretë të revistës letrare.
Vlerësimi i punonjësve për 6-mujorin.	Përgatitja e vlerësimeve të punonjësve të sektorit.	Dhjetor 2023	Punonjës të vlerësuar.
Përgatitja e raportimit vjetor për Sektorin e Botimit, Koordinimit dhe Shpërndarjes.	Përgatitja e raportit vjetor për veprimtarinë e realizuar nga sektori.	Dhjetor 2023	Raporti vjetor.

### 3. SEKTORI I KOMUNIKIMIT, DIGJITIMIT DHE PROJEKTEVE

Sektori Komunikimit, Digjitimit dhe Projekteve ka këto objektiva të detajuar për periudhën qershor-dhjetor 2023:

#### 3.1 DETYRAT KRYESORE

Detyrat kryesore të Sektorit të Komunikimit, Digjitimit dhe Projekteve, në QBD janë:

- Vendosja dhe mbajtja e lidhjeve me shoqatat, organizatat, qendrat, përfaqësitë brenda dhe jashtë vendit të cilat kanë diasporën si objekt të veprimtarisë së tyre;
- Ndjekja dhe koordinimi i veprimtarisë e marrëdhënieve të QBD-së me institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës për botimet për diasporën, institucione analoge institucionet e tjera që kanë lidhje me këto aktivitete, organizata ndërkombëtare, të huaj si dhe me organizma shkencorë e punonjës të shkencës në viset shqiptare në rajon dhe në diasporë;
- Mbajtja e lidhjeve me përfaqësitë diplomatike shqiptare në vende të ndryshme;
- Mbajtja e lidhjeve me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, si dhe institucionet e tjera brenda dhe jashtë vendit;
- Mbikqyrja e përditësimit të lajmeve dhe publikimeve në rrjetet sociale të institucionit;
- Hedhja dhe mbikqyrja e publikimeve të librave elektronikë në faqen e QBD-së;
- Bashkërendimi i punës për pjesëmarrjen e QBD-së në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Ndjekja e hartimit dhe mbarëvajtjes së punës dhe projekteve të miratuara nga Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën.

#### 3.2 OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM TË SEKTORIT TË KOMUNIKIMIT, DIGJITIMIT DHE PROJEKTEVE

Sektori Komunikimit, Digjitimit dhe Projekteve ka këto objektiva të përgjithshëm për periudhën qershor-dhjetor 2023:

- Krijimi, ruajtja dhe konsolidimi i marrëdhënieve të QBD-së;
- Krijimi, mirëmbajtja dhe pasurimi i faqes on line të librave në formë elektronike;
- Hartimi dhe ndjekja e projekteve të QBD-së.

### 3.3 OBJEKTIVAT E DETAJUAR TË SEKTORIT TË KOMUNIKIMIT, DIGJITIMIT DHE PROJEKTEVE

Sektori Komunikimit, Digjitimit dhe Projekteve ka këto objektiva të detajuar për periudhën qershor-dhjetor 2023:

- Organizim i aktivitetit vjetore të “Shqipja në Diasporë”;
- Organizimi i trajnimit të mësuesve të gjuhës dhe kulturës shqiptare në diasporë;
- Organizimi dhe sigurimi i pjesëmarrjes së QBD-së në panairë brenda dhe jashtë vendit;
- Ndjekja e zbatimit të projekteve të miratuara nga Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën;
- Hartimi dhe përgatitja e revistës informuese për shkollat shqipe në diasporë në bashkëpunim me Këshillin Koordinues të botimeve për Diasporën;
- Krijimin e projekteve të reja që do t’i sigurojnë QBD-së pjesëmarrje në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Ndjekja e aktiviteteve dhe mbledhjeve të Këshillit Koordinues të Arsimit në Diasporë;
- Sigurimi i një komunikimi efektiv, të koordinuar dhe të qëndrueshëm me institucione e individë të interesuar për punën dhe veprimtarinë e QBD-së;
- Menaxhimi i rrjeteve sociale të institucionit (Facebook, Instagram, Twitter, YouTube, LinkedIn);
- Përditësimi i portalit [www.qbd.gov.al](http://www.qbd.gov.al);
- Hedhja e librave ndihmës për mësimdhënien në diasporë në faqen e QBD-së;
- Organizimi i takimeve online të QBD-së;
- Përgatitja dhe realizimi i videove për mësimin e gjuhës shqipe në diasporë;
- Vlerësimi i punonjësve për 6-mujorin;
- Përgatitja e raportimit vjetor për Sektorin e Komunikimit, Digjitimit dhe Projekteve.

### 3.4 PLANI I VEPRIMTARIVE TË SEKTORIT TË KOMUNIKIMIT, DIGJITIMIT DHE PROJEKTEVE

OBJEKTIVI	MASAT E PËRGJITHSHME	PERIUDHA	REZULTATI
Organizim i aktivitetit vjetore të “Shqipja në Diasporë”.	Menaxhimi i organizimit të pjesëmarrësve dhe aktivitetit.	Shtator-nëntor 2023	Organizimi i aktivitetit të tretë “Shqipja në Diasporë”.
Organizimi i trajnimit të mësuesve të gjuhës dhe kulturës shqiptare në diasporë.	Përgatitja e moduleve të trajnimit për mësuesit e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë për tekstin e përbashkët.	Shtator-dhjetor 2023	Organizimi i trajnimeve të gjuhës shqipe në diasporë.
Organizimi dhe sigurimi i pjesëmarrjes së QBD-së në panairë brenda dhe jashtë vendit.	Përgatitja e materialeve promociionale që nevojiten për pjesëmarrjen në panairë	Gusht-nëntor 2023	Pjesëmarja në panairë.
Ndjekja e zbatimit të projekteve të miratuara nga Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën.	Realizimi i koordinimit të veprimtarisë së Këshillit.	Qershor-dhjetor 2023	Koordinimi i veprimtarisë së Këshillit.
	Pjesëmarja e QBD-së në takimet e Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën.	Gjatë 6-mujorit	Mbajtja e procesverbaleve dhe dokumentacionit të nevojshëm gjatë mbledhjeve të Këshillit, në cilësinë e sekretariatit teknik.
Hartimi dhe përgatitja e revistës informuese për shkollat shqipe në diasporë në bashkëpunim me Këshillin Koordinues të Botimeve për Diasporën.	Koordinimi i punës me Këshillin Koordinues të Botimeve për Diasporën për hartimin e përmbajtjes së revistës.	Korrik-Gusht 2023	Hartimi i përmbajtjes dhe fillimi i punës me përzgjedhjen e materialeve.
	Koordinimi i punës me Sektorin e Botimit, Koordinimit dhe Shpërndarjes për redaktimin e materialeve.	Shtator 2023	Revista e redaktuar.
	Realizimi i design-it të revistës.	Tetor 2023	Revista e përfunduar.
	Hedhja e revistës në faqen e ueb-it.	Tetor 2023	Revista e shfletueshme online.
Krijimin e projekteve të reja që do t’i sigurojnë QBD-së pjesëmarrje në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.	Sigurimi i pjesëmarrjes së QBD-së në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.	Korrik-dhjetor 2023	Programim, përgatitje dokumentacioni dhe aplikim, në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ndjekja e aktiviteteve dhe mbledhjeve të Këshillit Koordinues të Arsimitarëve në Diasporë.	Ndjekja e organizimit dhe zhvillimit të mbledhjeve të Këshillit Koordinues të Arsimitarëve në Diasporë.	Qershor-dhjetor 2023	Pjesëmarrja e QBD-së në mbledhjet e Këshillit Koordinues të Arsimitarëve në Diasporë.
Sigurimi i një komunikimi efektiv, të koordinuar dhe të qëndrueshëm me institucione e individë të interesuar për punën dhe veprimtarinë e QBD-së.	Komunikimi i vazhdueshëm me institucione dhe individë të interesuar për veprimtarinë e Qendrës.	Gjatë 6-mujorit	Përcjellaj e informacionit dhe ndjekja e korrespondencës së QBD-së.
Menaxhimi i rrjeteve sociale të institucionit (Facebook, Instagram, Twitter, YouTube, LinkedIn).	Promovimi i veprimtarisë së Qendrës së Botimeve për Diasporën.	Gjatë 6-mujorit	Promovimi i veprimtarisë dhe botimeve të QBD-së.
	Organizimi i kalendarit të postimeve në rrjetet sociale.	Gjatë 6-mujorit	Organizimi i postimeve.
Përditësimi i portalit <a href="http://www.qbd.gov.al">www.qbd.gov.al</a> .	Rikonceptimi, përshtatja teknike, përditësimi dhe pasurimi i faqes zyrtare të institucionit, me qëllim aksesueshmërinë e saj nga të gjitha kategoritë dhe grupet sociale.	Gjatë 6-mujorit	Faqe zyrtare web e përditësuar dhe e aksesueshme.
	Përcjellja e informacionit të plotë dhe të gjerë për publikut duke shfrytëzuar të gjitha mjetet e komunikimit, sidomos bashkëveprim me median.		
	Monitorimi dhe përditësimi i Programit të Transparencës me materiale të përditësuara.		
Hedhja e librave ndihmës për mësimdhënien në diasporë në faqen e QBD-së.	Përgatitja në format digjital dhe publikimi i librave ndihmës për mësimdhënien në diasporë, të cilët ofrohen falas nga QBD-ja.	Gjatë 6-mujorit	Librat e shfletueshëm online falas.
Organizimi i takimeve online të QBD-së.	Menaxhimi i procesit të organizimit të takimeve online, duke siguruar një komunikim sa më efikas.	Gjatë 6-mujorit	Mbledhje të zhvilluara online.
Përgatitja dhe realizimi i videove për mësimin e gjuhës shqipe në diasporë.	Organizimi i punës për realizimin e videove për mësimin e gjuhës shqipe në diasporë.	Gjatë 6-mujorit	Video ndihmëse për mësimin e gjuhës shqipe në diasporë.
Vlerësimi i punonjësve për 6-mujorin.	Përgatitja e vlerësimeve të punonjësve të sektorit.	Dhjetor 2023	Punonjës të vlerësuar.
Përgatitja e raportimit vjetor për Sektorin e Komunikimit, Digjitimit dhe Projekteve.	Përgatitja e raportit vjetor për veprimtarinë e realizuar nga sektori.	Dhjetor 2023	Raporti vjetor.

## 4. SEKTORI I FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

### 4.1 DETYRAT KRYESORE

Detyrat kryesore të Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në QBD janë:

- Menaxhim i buxhetit të Qendrës së Botimeve për Diasporën;
- Realizimi i analizave financiare të institucionit;
- Kryerja e të gjithë veprimtarive mbështetëse të QBD-së me qëllim plotësimin e misionit të saj.

### 4.2 OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM TË SEKTORIT TË FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Sektori Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse ka këto objektiva të përgjithshëm për periudhën qershor-dhjetor 2023:

- Ndjekja e regjistrit të parashimeve të QBD-së;
- Realizimi i raportimeve financiare për procedurat e realizuara;
- Kryerja e të gjithë veprimtarive mbështetëse të QBD-së me qëllim plotësimin e misionit të saj.

### 4.3 OBJEKTIVAT E DETAJUAR TË SEKTORIT TË FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Sektori Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse ka këto objektiva të përgjithshëm për periudhën qershor-dhjetor 2023:

- Menaxhimi buxhetor dhe financiar;
- Procedurat e prokurimeve publike;
- Përfaqësimi në proceset gjyqësore në zbatim të ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik, si dhe çështje të tjera me objekt të ndryshëm nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale dhe ligji për të drejtën e informimit;
- Bashkëpunim dhe koordinim me strukturat e tjera të institucionit;
- Përpunim i dokumentacionit të arkivës së institucionit;
- Vlerësimi i punonjësve për 6-mujorin;
- Përgatitja e raportimit vjetor për Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

#### 4.4 PLANI I VEPRIMTARIVE TË FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

OBJEKTIVI	MASAT E PËRGJITHSHME	PERIUDHA	REZULTATI
Menaxhimi buxhetor dhe financiar.	Menaxhimi i burimeve financiare dhe koordinimi me çdo strukturë, për monitorimin në vazhdimësi të procesit të menaxhimit financiar.	Gjatë 6-mujorit	Sistem efektiv menaxhimi.
	Hartimi i urdhrave për menaxhimin e sistemit të prokurimeve publike, sipas rolit dhe përgjegjësi konkrete.	Gjatë 6-mujorit	Regjistri i realizimeve.
Përfaqësimi në proceset gjyqësore në zbatim të ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik, si dhe çështje të tjera me objekt të ndryshëm nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale dhe ligji për të drejtën e informimit.	Përgatitja e prapësimeve, autorizimeve dhe ankimimeve.	Gjatë 6-mujorit	Prapësime, konkluzione përfundimtare, ankimime dhe akte të tjera administrative.
	Përfaqësim dhe ndjekja e proceseve gjyqësore.	Gjatë 6-mujorit	Përgatitja e tabelës statistikore mbi proceset gjyqësore të QBD-së..
Bashkëpunim dhe koordinim me strukturat e tjera të institucionit.	Ndjekje dhe zhvillim i procedurave të brendshme administrative.	Gjatë 6-mujorit	Hartimi i akteve rregullatore të brendshme.
	Dhënia e mendimeve profesionale në çdo vendimmarrje institucionale përpara miratimit.	Gjatë 6-mujorit	
Përpunim i dokumentacionit të arkivës së institucionit.	Hartimi dhe miratimi i proceseve standarde të miratimit për arkivimin e dokumentacionit.	Gjatë 6-mujorit	Arkiv dokumentacioni i organizuar sipas parashikimeve ligjore.
	Kryerja e procesit të inventarizimit të asetëve/aktiveve të institucionit çdo vit dhe nxjerrja e akteve sipas rezultatit.	Nëntor-dhjetor 2023	Inventarizim asetesh.

Vlerësimi i punonjësve për 6-mujorin.	Përgatitja e vlerësimeve të punonjësve të sektorit.	Dhjetor 2023	Punonjës të vlerësuar.
Përgatitja e raportimit vjetor për Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.	Përgatitja e raportit vjetor për veprimtarinë e realizuar nga sektori.	Dhjetor 2023	Raporti vjetor.
Procedurat e prokurimeve publike për vitin 2023.	Hedhja në sistem dhe realizimi i prokurimeve publike të parashikuara në regjistrin e prokurimeve publike për vitin 2023	Gjatë 6-mujorit	Regjistri i realizimeve dhe arkivimi në SPE.